



# Kapitali njerëzor i Kosovës

## Themeli që mungon për Rritjen Ekonomike dhe Transformimin Social



### Indeksi i ulët i Kapitalit Njerëzor

Fëmijët e lindur në Kosovë sot do të jenë vetëm sa gjysma produktiv krahasuar me të rriturit nëse do të pranon arsim dhe shërbime shëndetësore të forta



### Një fuqi punëtore pa kualifikime për vende pune moderne

Në moshën 15 vjeç, vetëm 20% e të rinjve kanë shkrim-lexim funksional; vetëm 23% kanë matematikë funksionale

## Problemet e rrënjosura në mangësi gjatë fëmijërisë së hershme

### Shëndetësia



Kostot e larta nga xhepi (mbi 30% e shpenzimeve) pengojnë qasjen në kujdesin kritik



Norma e lartë e vdekshmërisë foshnjore dhe të fëmijëve; mungesa e kontrolleve të rregullta shëndetësore për gratë dhe fëmijët



### Arsimi dhe kujdesi i hershëm



77% e fëmijëve që hyjnë në arsimin parafillor janë nën standardet për shkrim-lexim dhe matematikë



Më pak se 7% e fëmijëve nën moshën 5 vjeç kanë qasje në parashkollore dhe qendrat e kujdesit

### Mbrojtja sociale



Rrjeti i sigurisë kombëtare nuk mbulon shumë familje të varfra; përkrahja me të ardhura për familjet e mëdha është e pamjaftueshme



Qasja reaktive ndaj shërbimeve sociale rrezikon t'i ekspozojë fëmijët ndaj dëmit

# Rruga kritike për ta përmirësuar mirëqenien e fëmijëve të vegjël dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor



## 1 Një strategji kombëtare për fëmijërinë e hershme



**Një qasje e integruar** që siguron se të gjitha cenueshmëritë e secilit fëmijë adresohen në të njëjtën kohë



**Udhëheqje e fortë qendrore** për ta nxitur bashkëpunimin ndër-sektorial dhe rezultatet që tejkalojnë punën e sektorëve individualë



**Fokus në nevojat e familjeve** kështu që prindërit kanë shëndetin dhe resurset për të siguruar atë që u nevojitet fëmijëve për zhvillim të shëndetshëm



**Lidhje më të mira në mes të sektorëve** përmes referimeve, menaxhimit të rasteve, një platforme të shkëmbimit të të dhënave dhe sistemeve të fuqishme sektoriale të të dhënave

## 2 Zbatimi i përmirësuar i politikave dhe programeve ekzistuese

### Shëndetësia

- ✓ Të ulen kostot nga xhepi për shërbimet bazë
- ✓ Të përmirësohet cilësia e shërbimeve shëndetësore për foshnjat, fëmijët, gratë shtatzëna dhe nënat e reja

### Arsimi

- ✓ Të zgjatet orari i parafillorit, rishikimi i kurrikulës
- ✓ Të zgjerohet qasja në parashkolloret cilësore përmes partneriteteve publike-private dhe stimujve për licencim

### Mbrojtja sociale

- ✓ Të zgjerohet përkrahja për familjet e varfra përmes reformës së kriterëve të pranueshmërisë për SNS dhe formulës së përfitimeve
- ✓ Të zbatohet qasja proaktive dhe parandaluese ndaj shërbimeve sociale

## 3 Vlerësimet e investimeve shtesë

Arritja e caqeve afatgjatë për kapitalin njerëzor dhe rritjen ekonomike do të kërkojë investime shtesë në zhvillimin në fëmijërinë e hershme



**Kostimi i saktë i planit afatgjatë**



**Strategjia për sigurimin e resurseve fiskale**